



qendra e provimeve

**MASA**

E VËRTETË

E NJOHURIVE

**GARAT  
SHTETËRORE**

**2017**

SHIFRA E NXËNËSIT

SHKOLLA FILLORE, KLASA VI

**MATEMATIKË**

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PIKËVE TË FITUARA

Testin e kontrollloi

Podgoricë, ..... 20.....



## UDHËZIM PËR PUNË

Të dashur nxënës dhe nxënëse,

Urime! Keni arritur që të vini në garat shtetërore nga matematika dhe me këtë hap keni arrite një sukses të madh. Prandaj detyrat që janë para jush shikoni si një problem interesant dhe përpiquni që t'i zgjidhni me një kujdes dhe angazhim të plotë, por edhe me një kënaqësi.

Renditja e punimit të detyrave nuk ka rëndësi. Nëse ndonjë detyrë ju duket shumë e vështirë, mos u ndalni shumë në të, por kaloni në detyrën tjetër. Nëse ju mbetet kohë, kthehuni dhe provoni t'i zgjidhni përsëri ato detyra të cilat nuk i keni zgjidhur.

*Shkruani lexueshëm, posaçërisht numrat!*

Punoni në mënyrë të pavarur. Nuk lejohet asnjë lloj bashkëbisedimi. Nëse ndokush në ndonjë mënyrë pengon punën, do të përjashtohet nga garat.

Gjatë punës mund të shfrytëzoni veglat shkollore për vizatimin e figurave gjeometrike, por nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë, kalkulatorëve dhe mjeteve tjera ndihmëse elektronike.

Për çdo detyrë janë paraparë nga 25 pikë.

*Për punë keni 180 minuta.*

Mund të filloni nga puna. Me fat!



1. Tina më 1 qershor të vitit 2016 ka filluar të punojë detyrat nga përmbledhja që ka 360 detyra. Ka punuar katër ditë nga tetë detyra, dy ditë nuk ka punuar fare, pastaj përsëri ka punuar katër ditë nga tetë detyra, mandej ka pushuar dy ditë dhe kështu me radhë derisa nuk i ka zhvilluar të gjitha detyrat nga përmbledhja e detyrave. Mario më 1 qershor ka filluar me punimin e detyrave nga ajo përmbledhje, duke punuar gjashtë ditë nga nëntë detyra, pastaj një ditë ka pushuar, mandej përsëri gjashtë ditë nga nëntë detyra dhe një ditë ka pushuar, dhe kështu me radhë deri në përfundimin e përmbledhjes së detyrave.

Kush i ka punuar i pari të gjitha detyrat nga përmbledhja?

2. Përcaktoni të gjitha treshet e numrave treshifrorë  $(a, b, c)$  në të cilët është  $a < b < c$  dhe  $a + b + c = 2017$ , nëse është e njohur se është  $PMP(a, c) = 40$ , dhe është dhënë numri  $b$  i shkruar duke përdorur tri shifrat e njëjta.

3. Dy kuti, në formë të katrorit pa kapak, janë ndërtuar nga llamarinë me trashësi të njëjtë. Brinja e kutisë më të vogël është 1 dm, kurse ajo më e madhe është 2 dm. Masa e kutisë më të madhe, kur është e zbrazët është 1kg. Masa e kutisë më të vogël e mbushur me sheqer deri te tri të katërtat e lartësisë së saj gjithashtu është 1 kg. Sa gram sheqer qëndron në kutinë e madhe?

4. Është dhënë rrjeti prej nëntë katrorëve me brinje të njëjta në të cilën janë tërhequr dy segmente fundet e të cilave janë në kulmet e katrorit si në figurë. Të llogaritet shuma  $\alpha + \beta$ , ku  $\alpha$  dhe  $\beta$  janë këndet e shënuara në figurën e dhënë.















